



PUBLIC

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministerstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministrit - Ured Ministra - Office of the Minister

Prishtina, 12 Maj 2022

Për: Znj. Mappie Veldt – Foglia, Kryegjykatëse,
Dhomat e Specializuara të Kosovës

Për dijeni të:

- Z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës
- Znj. Fidelma Donlon, Administratore, DhSK

Lënda: Përgjigje në lidhje me shkresën KSC – BC – 2020 – 05

E nderuar znj. Veldt – Foglia,

Më poshtë gjeni përgjigjet në të gjitha pyetjet e shtruara:

1. Nëse, në rast të një dënim i z. Salih Mustafës (të akuzuarit) dhe të lëshimit të Urdhrit për kompensim nga Kolegji, i Akuzuarit nuk është në gjendje që të paguaj çfarëdo kompensimi të urdhëruar nga Kolegji, a mund viktimat e krimeve nën juridikcionin e Dhomave të Specializuara (DhS) të përfitojnë nga dëmshpërblimi nga Fondi i Kompensimit të Viktimateve të cekur në nenin 19(1), seksioni 1.26, dhe 62(1), nen 1.5, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ose nga çdo program tjetër përkatës kompensimi, përfshirë atë të krijuar sipas Ligjit Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimateve të Krimtit (Pyetja 1).

- Viktimat e krimtit, duke përfshirë edhe viktimat nën jurisdikcionin e Dhomave të Specializuara (personalisht apo përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij - mbrojtësi i viktimateve apo avokati privat), mund të përfitojnë kompensimin apo dëmshpërblimin nga Fondi i Kompensimit të Viktimateve në Kosovës (si program i vetëm i themeluar për këtë qëllim),

PUBLIC

vetëm pasi që fillimisht të kërkojnë dëmshpërblim nga i akuzuari dhe në rastet kur vërtetohet se i akuzuari nuk mund që të ofrojë dëmshpërblimin pjesërisht apo tërësisht për viktimen.

Nëse gjykata (kolegji) nuk mund të urdhërojë kopensimin nga i pandehuri, për shkak të rrëthanave të përcaktuara në Ligj, i dëmtuari ka të drejtë që të kërkoj nga gjykata (kolegji) që të dërgoj urdhrin për kompensim te koordinatori i Fondit për Kompensimin e Victimave.

Veprat penale për të cilat mund të kompensohen apo të përfitojnë dëmshpërblim, procedura për realizimin e kompensimit apo dëmshpërblimit, kushtet (formale dhe materiale) dhe kriteret për kompensim janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi për kompensimin e victimave të krimtit.

2. Nëse viktimat e krimeve nën juridikcionin e DhS-së mund të përfitojnë nga dëmshpërblimi nga Fondi i lartpërmendur i Kompensimit të Victimave ose nga çdo program tjeter përkatës, a mundet kompensimi të mbetet anonim pas lëshimit të urdhrit për kompensim nga Kolegji (Pyetja 2).
 - Anonimiteti është pjesë integrale e kornizës ligjore të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe si i tillë gjenë vend edhe zbatim në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Edhe pse nuk është cekur taksativisht për raste të tilla, konsiderojmë dhe vlerojmë se kompescimi apo dëmshpërblimi i victimave të krimtit nën jurisdikcionin e Dhomave të Specializuara, pas lëshimit të urdhrit për kompensim, nëse është e arsyeshme për të shmangur çfarëdo rrethane eventuale të krijuar që do të ndikonte në dinjitetin e viktimit së krimtit, mund të mbetet anonim, por vetëm përtej personave kompetent që merren me administrimin dhe ekzekutimin e kërkesës për kompensim (Komisioni dhe Njësia Përkatëse).

Me këtë rast, bëjmë me dije se anonimiteti vjen në shprehje në të gjitha rastet e tjera, përveç gjatë trajtimit dhe administrimit të lëndës nga personat kompetent.

PUBLIC

Edhe ashtu, sipas legjisacionit përkatës në fuqi, dokumentet përcjellëse të kërkesës për kompensim janë konfidenciale dhe trajtohen si të tilla dhe parashtruesi i kërkesës duhet të jep pëlqimin e vet për përpunimin e të dhënave personale, në rast nevoje.

3. Për të ruajtur anonimitetin e viktimateve, a mundet Administratori, me ndihmën e Ministrisë së Drejtisës, sipas nevojës, të aplikojë për dëmshpërbirim nga Fondi i lartpërmendur i Kompensimit të Viktimateve ose nga çdo program tjeter përkatës kompensimi në emër të viktimateve, pas lëshimit të urdhrit për kompensim nga Kolegji (Pjetja 3).
 - Pas lëshimit të urdhrit për kompensim nga gjykata (kolegji), legjisacioni përkatës në fuqi përcakton qartë se viktima e krimtit mund të kërkojë ndihmën e mbrojtësit të viktimateve apo organizatave jo qeveritare që ofrojnë ndihmë juridike falas apo angazhimt të ndonjë avokati privat.

Për njoftimin tuaj, termi "përfaqësues i autorizuar" nënkupton personin fizik apo juridik që pala me autorizim (prokurë) i jep të drejta dhe detyrime që të veprojë në emër dhe për llogari të palës.

Është në diskpcionin e viktimes së krimtit për ti dhënë besimin personit fizik apo juridik për të përfaqësuar në procedura të tilla dhe është detyrim i të autorizuarit që të ruaj anonimitetin e viktimes dhe konfidentialitetin e informative, veçanërisht kur kemi të bëjmë me raste të ndjeshme.

Në rastin konkret, për të shhangur çfarëdo lloj elementi të konfliktit të interesit, administratori nuk mund të jetë si i autorizuar i viktimes së krimtit për të kerkuar në emër të saj kompensimin apo dëmshpërbilimin në Fond.

4. Nëse, në rast se viktimat e krimeve nën juridiksionin e DhS-së nuk mund të përfitojnë nga dëmshpërbimi nga cilido program ekzistues kompensimi për këtë qëllim, a mund të krijohet një fond i financuar nga buxheti i Kosovës ose në ndonjë mënyrë tjeter, për të cilin Administratori do të mund të aplikonte për kompensim në emër të viktimateve, për të ruajtur anonimitetin e tyre. Në këtë kontekst, Kolegji posaçërisht thekson se financimi i mbrojtjes së personave të akuzuar

PUBLIC

pranë DhS-së nga buxheti i Kosovës mundësohet me anë të Ligjit Nr. 05-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare për të akuzuarit potencial në proceset gjyqësore pranë DhS-së (Pjetja 4).

- Aktualisht nuk kemi një rregullim të tillë ligjor, por mundësia e themelimit të një fondi të veçantë dhe të një rregullore të veçantë mbi bazën e së cilës do të aplikohet kjo procedurë, gjithmonë është relative, përmes dhënies së autorizimit ligjor në një ligj ekzisutes.

Pra, organi legjislativ, nëse ekziston një vullnet i tillë mund të themelojë fonde të veçanta dhe të aplikojë rregullore të veçantë për zbatimin e realizimit të kërkesave për dëmshpërblim nga ai fond i veçantë, përmes krijimit të një kornize ligjore.

Ndërsa, organet ekzekutive, mund ti themelojnë këto fonde vetëm nëse kanë një bazë të caktuar në një ligj të veçantë, siç është rasti i financimit të mbrojtësve të akuzuar pranë Dhomave të Specializuara, që bëhet përmes Ligjit nr. 05/L-054 për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare për të akuzuarit potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

Mirëpo, momentalisht program përkatës i themeluar për këtë qëllim është Fondi i Kompensimit, ku viktima e krimtit nënkupton viktimin siç definohet me Kodin e Procedurës Penale, e që rrjedhimisht bëjnë pjesë edhe viktimat e krimtit nën juridikcionin e Dhomave të Specializuara.

Ndërsa, si mekanizëm përkatës për të shqyrtau kërkesat për kompensim është Komisioni Qeveritar për Kompensimin e Víktimave të Krimít, i cili nuk ka diskrecion të që refuzojë një kërkesë për kompensim, kur ajo i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore.

Përkundrazi, ky Komision, kur plotësohen kushtet ligjore, mund të shqyrtojë kërkesat për kompensim edhe për kategori tjera të veprave penale (përveç atyre që parashihen si të kompenzueshme), nga personat që pretendojnë që janë viktima të krimtit të veprave të tjera të dhunshme.

PUBLIC

Sa i përket parashkrimit, ashtu siç e përcaktojnë rregullat në fuqi, kërkesa për realizimin e kompensimit në Fond, parashkruhet në afatin prej 6 (gjashtë) muajsh, nga dita e plotëfuqishmërisë së vendimit gjyqësor.

Ministria e Drejtësisë, mbetet e përkushtuar për adresimin e secilës çështje konkrete përkitazi me zbatimin e kompensimit të viktimave të krimit nën juridikcionin e Dhomave të Specializuara, në linjë të kërkesave nga DhS.

Ju faleminderit!

